

HUSEJN AVAJISHE



Të udhëheqësh vetveten dhe familjen

[sipas asaj që shpalli Allahu]

TË UDHËHEQËSH VETVETEN DHE FAMILJEN TËNDE SIPAS ASAJ QË ALLAHU SHPALLI

Husejn el-Awajisheh

Marrja e rabinëve dhe e murgjve për zota	2
Gjykimi sipas asaj që Allahu shpalli - Si?	4
Rëndësia e hulumtimit dhe verifikimit.....	7
Gjykimi me tjetër veças asaj që Allahu shpalli	10
Gjykimi me atë që Allahu shpalli në të gjitha çështjet.....	16
Dëgjueshmëri dhe nënshtrim i plotë	20
Prioritetet	26
Çdo person është përgjegjës dhe prijës.....	30
Mungesa e të kuptuarit.....	38
Ta njohësh Allahun e madhëruar	43
Efektet e këqija të gjynaheve.....	44
Rëndësia e dijes.....	46
Shembuj të mendjemadhësisë dhe përçmimit.....	47
Përfundim.....	51

Marrja e rabinëve dhe e murgjve për zota

Allahu i lartësuar tha lidhur me çifutët dhe të krishterët:

اتَّخَذُوا أَحْبَارَهُمْ وَرُهَبَانَهُمْ أَرْبَابًا مِّن دُونِ اللَّهِ وَالْمَسِيحَ ابْنَ
مَرْيَمَ وَمَا أُمُّرُوا إِلَّا لِيَعْبُدُوا إِلَهًا وَاحِدًا ۚ لَّا إِلَهَ إِلَّا هُوَ سُبْحَانَهُ عَمَّا
يُشْرِكُونَ ﴿٣١﴾

“Ata (çifutët dhe të krishterët) i morën rabinët e tyre dhe murgjit e tyre për zota krahas Allahut, dhe Mesinë, birin e Merjemes, ndërsa kanë qenë urdhëruar (në Tewrat dhe në Inxhil) të mos adhurojnë tjetër veçse një Zot). Kurrkush s’ka të drejtë të adhurohet veç Tij. I lartë dhe i lavdishëm është Ai nga ajo që i shoqërojnë”. (et-Tewbe, 31)

Nëse Allahu i madhëruar ndalonte një çështje që rabinët dhe priftërinjtë e tyre e konsideronin të lejueshme, çifutët dhe të krishterët e kundërshtonin Allahun dhe pasonin rabinët dhe priftërinjtë. Po ashtu, nëse Allahu i patëmeta lejonte një veprim që rabinët dhe priftërinjtë e ndalonin, çifutët dhe të krishterët i dëgjonin këta të fundit dhe e konsideronin atë veprim të ndaluar. Kështu, të krishterët dhe çifutët i morën rabinët dhe murgjit për zota të tyre krahas Allahut të lavdishëm.

Adi ibn Hatim (radi Allahu anhu) tha:

“Shkova te pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) dhe po mbartja në qafë një kryq të artë. Ai (salallahu alejhi ue selam) tha: ‘O **Adi**, **hiqe atë idhull**’. Dhe e dëgjova atë të recitonte suren *Bera’eh* (Tewbe): ‘Ata (çifutët dhe të krishterët) i morën rabinët e tyre dhe murgjit e tyre për zota krahas Allahut’. Ai

(salallahu alejhi ue selam) tha: 'E vërtetë. Ata nuk i adhuronin ata (rabinët dhe murgjit), por, kur ata (rabinët dhe murgjit) vendosnin për diçka se është e lejueshme për ta, ata (çifutët dhe të krishterët) e konsideronin atë gjë të lejueshme (edhe pse Allahu ua ndalonte atë); kur ata i ndalonin ata nga ndonjë gjë, ata e konsideronin atë gjë të ndaluar (edhe pse Allahu vendoste se ajo ishte e lejuar)'''.¹

Në një tjetër transmetim të hadithit të njëjtë, transmetohet se Adi ibn Hatim, i cili kishte qenë i krishterë më herët, shkoi te pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) dhe, kur pejgamberi e recitoi këtë ajet, ai tha: "O i Dërguar i Allahut, vërtet, ata (të krishterët dhe çifutët) nuk i adhurojnë ata (rabinët dhe murgjit)". Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha: "Përkundrazi (dmth se ata vërtet e bëjnë këtë). Vërtet, ata (rabinët dhe murgjit) i ndaluan ata nga e lejueshmja dhe e lejuan të ndaluarën, dhe ata (të krishterët dhe çifutët) i pasuan në këtë. Ky është adhurimi që ata u bënë atyre''".²

Allahu i lavdishëm thotë në ajetin e lartpërmendur se çifutët dhe të krishterët i morën rabinët dhe murgjit për zota të tyre krahas Allahut. Mirëpo, ata nuk i adhuronin nëpërmjet namazit, tawafit apo ndonjë akti tjetër të sipërfaqshëm. Prandaj, nga ajeti dhe nga hadithi i Adit na bëhet e qartë se të mos gjykosh sipas asaj që Allahu shpalli është formë adhurimi. Në situata të caktuara, personi mund të adhurojë tjetër pos Allahut të lavdishëm, kur kërkon gjykim lidhur me ndonjë çështje gjetskë e jo në Sheriatin e Allahut.

¹ Transmetuar nga et-Tirmidhi, *Sahih Sunen et-Tirmidhi* (2471).

² Ky është hadith hasen, të cilin shejhu jonë (Albani) e përmendi në *el-Mustalehât el-Erba'eh fil-Kur'an* (f.18-20).

Gjykimi sipas asaj që Allahu shpalli - Si?

Me pak fjalë, me qëllim që të gjykohet sipas asaj që Allahu fuqimadh shpalli, ne duhet ta konsiderojmë (në besim dhe veprim) të ndaluar atë që Allahu e ndaloi dhe duhet ta konsiderojmë të lejuar atë që Allahu e lejoi³.

Për të bërë këtë, ne duhet të dimë se çka është e lejuar e çka e ndaluar. Dhe ne duhet të kërkojmë gjykimin e Allahut të patëmeta në të gjitha çështjet – në namaz, në agjërim, në zekat e haxh, në gosti martesore e funerale, në mënyrën e veshjes, në ushqimin e pijen tonë, në çështjet individuale, familjare e shoqërore e shtetërore; në çështjet e biznesit, në çështjet e paqes e të luftës, shkurt, ne duhet të kërkojmë gjykimin e Allahut të plotfuqishëm në të gjitha çështjet e jetës sonë.

Në lejoni të theksojmë se personi nuk gjykon sipas asaj që Allahu shpalli, nëse:

- Ai pretendon se ka nevojë të vendoset ligji islamik si sistem jete, por ai kërkon një shumë të tepruar parash për prikë (*mehr*) të bijës, duke pohuar se do që t'ia sigurojë pavarësinë financiare në të ardhmen
- Ai i fton të tjerët të vendosin ligjin islamik si sistem jete, por u nënshtrohet traditave e zakoneve të shoqërisë së tij

³ Sa u përket qëndrimeve të cilat dijetarët i nxjerrin nëpërmjet ixhtihadit (nxjerrjes së vendimeve nga burimet e shpallura), nuk është me vend që të thuhet se ata e ndalojnë atë që është lejuar apo e lejojnë atë që është ndaluar. Në fakt, një dijetar shpërblehet për mundin e dhënë gjatë gjykimit bazuar në atë që nxjerrë nga Kurani dhe Suneti (natyrisht, vetëm në çështjet ku një vendim nuk përmendet qartë në Kuran dhe në Sunet). Në një hadith të vërtetë, pejgamberi (salallahu alejhi ue selam):

"Kur një gjykatës nxjerr një vendim të saktë, ai merr dy shpërblime; kur ai nxjerr një vendim të pasaktë, ai merr një shpërblim".

– sidomos ngjarjeve gazmore – që bien në kundërshtim me mësimet islamike

- Ai propagandon nevojën për vendosjen e ligjit islamik, por, kur ka të bëjë me funerale, ai nuk ndjek udhëzimin e pejgamberit (salallahu alejhi ue selam), por traditat e trashëguara nga prindërit dhe gjyshërit e tij
- Ai fton të tjerët për të vendosur ligjin islamik si një sistem jete, por vepron në kundërshtim me udhëzimin e pejgamberit (salallahu alejhi ue selam) në adhurimin e tij, në sjellje dhe në marrëveshje

Allahu fuqimadh thotë:

إِنَّ الْحُكْمَ إِلَّا لِلَّهِ أَمَرَ أَلَّا تَعْبُدُوا إِلَّا إِيَّاهُ ذَلِكَ الدِّينُ الْقَيِّمُ وَلَكِنَّ أَكْثَرَ النَّاسِ لَا يَعْلَمُونَ ﴿٤٠﴾

"Urdhri (apo gjykimi) s'i takon kurrkujt pos Allahut. Ai urdhëroi që ju të mos adhuroni dikë tjetër pos Tij, se kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë" (Jusuf, 40)

Pavarësisht se sa e madhe apo e vogël të jetë çështja, gjykimi për të i takon Allahut të plotfuqishëm. Njerëzit veprojnë në kundërshtim me gjykimin, me urdhrat dhe ndalimet e Allahut për një mori arsyes. Disa për shkak të krenarisë fisnore apo stërgjyshore, disa për shkak të dashurisë ndaj pasurisë, ndaj një partie politike, ndaj një personi, dijetari apo grupi, dhe disa për shkak të arsyeve tjera të ngjashme.

Nëse duam të gjykojmë sipas asaj që Allahu shpalli, duhet të dimë tekstin e shpallur, i cili na e bën të qartë të lejuarën nga e ndaluara. Natyrisht që kjo kërkon nga ne të mundohemi për të

nxënë dije, të mblidhemi rreth dijetarëve, të zhytemi në libra dhe të mësojmë nga dijetarët e gjeneratave të hershme të këtij umeti. Secili person duhet të përpiqet sipas mundësive dhe talentit që ka. Disa janë dijetarë, kështu që ata duhet t'i mësojnë të tjerët; dhe gjithkush tjetër duhet të mësojë. Me përjashtim të dijetarëve eruditë, njerëzit duhet të jenë të kujdesshëm të mos japin fetwa; ata duhet t'i përkushtohen mësimi. Krejt kjo na çon në:

Rëndësia e hulumtimit dhe verifikimit

Pa hulumtim dhe verifikim të informatave, personi s'mund të gjykojë sipas asaj që Allahu fuqimadh shpalli⁴. Feja është: "Allahu ka thënë", "i Dërguari i Allahut ka thënë" dhe "Sahabët kanë thënë".

Në hulumtimin e këtyre burimeve, ne duhet të verifikojmë se nuk po ndjekim transmetime të shpikura. Kurani – lavdi i qoftë Allahut – është i sigurt dhe i pastër nga shpikjet. Megjithatë, ne duhet të hulumtojmë tefsirin apo interpretimin e Kuranit, për t'u siguruar se një interpretim i caktuar është në pajtim me atë që Allahu i plotfuqishëm ka synuar. Nëse nuk qajmë kokën për të verifikuar saktësinë e një interpretimi, njerëzit nuk do të jenë në gjendje të zbatojnë atë që Allahu i patëmeta shpalli.

Sa i përket Sunetit, bidatet paraqesin një problem serioz. Kur themi "I Dërguari i Allahut tha", ne po flasim rreth fesë, dhe, nëse dikush gënjen ndaj pejgamberit (salallahu alejhi ue selam) lidhur me ndonjë hadith, atëherë ai ka gënjyer dhe ndaj Allahut të madhëruar. Kjo gënjeshtër do të çojë në ligjvënie të gabuar në fe; të gabuar sepse është një ligjvënie të cilën Allahu nuk e ka autorizuar. Prandaj, mosverifikimi i vërtetësisë se një hadithi rezulton në vendime dhe gjykime që bien në kundërshtim me atë që Allahu i madhëruar shpalli.

Po, ne i përbuzim ateistët ngaqë devijojnë nga e vërteta dhe nga rruga e Allahut; ata haptazi pranojnë armiqësinë e tyre ndaj Islamit dhe mosbesimin e tyre në Allahun e lartësuar. Por, si

⁴ Natyrisht që nuk them se gjithkush duhet të jetë dijetar, meqë jam i vetëdijshëm për të vërtetën e njohur e cila thotë: "Nëse do që të dëgjohesh, kërko vetëm atë që mund të bëhet". Angazhimi për t'u bërë dijetar është obligim kolektiv; mjafton që një grup personash të bëhen dijetarë, kurse të tjerët lirohen nga përgjegjësia e të bërit dijetarë. Megjithatë, ata që s'kanë mundësi të studiojnë dhe të arrijnë dije, duhet të përfitojnë nga ata që studiojnë dhe arrijnë dije.

ndjehemi lidhur me ata që devijojnë nga e vërteta dhe nga rruga e Allahut ndërsa pohojnë se po kërkojnë kënaqësinë e Allahut dhe po i shërbejnë Islamit!

Është e çuditshme dhe dëshpëruese që disa njerëz i përqeshin ata që ndjekin metodologjinë e hulumtimit dhe verifikimit shkencor. Ata argumentojnë se "Një saktësi e tillë në verifikim i pengon njerëzit nga bërja e veprave!" Por, cilave vepra ata u referohen - të këqijave apo të mirave? Ata sigurisht që u referohen veprave të mira, pasi këto janë veprat që muslimanët mundohen t'i bëjnë. Atëherë, çka është një vepër e mirë? Si ta dimë se një vepër është e mirë, apo e keqe? Kur orvatemi të japim përgjigje në këto pyetje, a duhet të ndjekim mendjet dhe dëshirat tona, apo duhet të ndjekim tekstin e shpallur? Ebu Sulejman ed-Darani tha:

"Nëse personi frymëzohet për të bërë një vepër të mirë, ai s'duhet ta bëjë atë, derisa të dëgjojë për të nga ndonjë transmetim autentik. Sapo të dëgjojë rreth saj nga ndonjë transmetim autentik, ai duhet ta bëjë atë vepër dhe ta falënderojë Allahun duke u treguar mirënjohës për bereqetin e të mësuarit (të një transmetimi) që është në përputhje me atë që tashmë gjendet në zemrën e tij"⁵.

Vepra e mirë përmendet në një numër ajetesh në Kuran. Për shembull, Allahu fuqimadh thotë:

فَمَنْ كَانَ يَرْجُوا لِقَاءَ رَبِّهِ فَلْيَعْمَلْ عَمَلًا صَالِحًا وَلَا يُشْرِكْ بِعِبَادَةِ

رَبِّهِ أَحَدًا ﴿٣١﴾

⁵ Referoju Tefsir Ibn Kethir, el-Ankebut, 69.

“Kush shpreson të takojë Zotin e vet, le të bëjë vepër të mirë dhe të mos shoqërojë gjë në adhurimin ndaj Zotit” (el-Kehf, 110)

Në Tefsirin e tij, Ibn Kethir thotë:

“Le të bëjë mirë” i referohet veprave që janë në përputhje me Sheriatin e Allahut. Kurse 'të mos shoqërojë që në adhurimin ndaj Zotit' do të thotë të bësh një vepër duke kërkuar kënaqësinë e Allahut, pa i shoqëruar Atij ortakë në këtë. Këto janë dy shtyllat e një veprë të pranuar, meqë vepra duhet të bëhet sinqerisht për Allahun e lartësuar dhe duhet të jetë e saktë, në pajtim me Sheriatin e të Dërguarit (salallahu alejhi ue selam)“.

Prandaj, vepër e mirë është ajo, që është në harmoni me Sheriatin e Allahut, që do të thotë se është dhe në harmoni me Sheriatin e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selam). Personi s'mund të arrijë këtë harmoni apo saktësi pa kaluar së pari në një proces të hulumtimit, verifikimit dhe vërtetimit.

Synimi dhe preokupimi yt s'duhet të jetë vetëm në bërjen e shumë veprave, pasi disa apo të gjitha ato vepra mund të jenë në kundërshtim me udhëzimin e pejgamberit (salallahu alejhi ue selam). Synimi dhe preokupimi yt duhet të jetë bërja e veprave të mira që janë në harmoni me Sheriatin e Allahut të madhëruar.

Gjykimi me tjetër veças asaj që Allahu shpalli

Allahu i lartësuar thotë:

وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْكَافِرُونَ ﴿٤٤﴾

"Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ata janë qafira". (el-Maideh, 44)⁶

⁶ Në Tefsirin e tij, el-Beghaui tha:

"Sa i përket thënies së Tij 'Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ata janë qafira' dhe (në ajetet tjera: ata janë) *dhalimûn* dhe *fasikûn*, është transmetuar nga el-Berâ ibn Azib se këto ajete u janë adresuar mosbesimtarëve. Po ashtu, është thënë se këto ajete u janë adresuar të gjithë njerëzve. Ibn Abas dhe Tawus thanë:

'Kjo nuk i referohet kufrit (mosbesimit) që të heqë prej fesë, por, nëse personi vepron kësioj, ai e mohon atë (dmth e mohon atë vendim të veçantë që e refuzon), dhe ai s'është si ai që mohon Allahu dhe Ditën e Fundit'.

Atë tha:

'Kjo është kufr më i vogël, *dhulm* më i vogël dhe *fisk* më i vogël'.

Ikrimah tha:

'Kjo do të thotë se, nëse personi nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, duke e bërë këtë ngaqë ai mohon (atë çka Allahu shpalli), atëherë ai bën kufr të madh. Dhe, nëse personi pranon atë çfarë Allahu shpalli, por nuk gjykon me të, ai është *dhalim* (keqbërës) dhe *fasik* (i pabindur, rebel)'.

Kur AbdulAziz ibn Jahja el-Kennâni u pyet rreth këtyre tri ajeteve, ai tha:

'Këto nuk vlejnë vetëm për pjesët që Allahu i shpalli, por për gjithçka që Allahu shpalli. Kushdo që nuk gjykon sipas çdo gjëje që Allahu shpalli, është qafir (mosbesimtar), *dhalim* (keqbërës) dhe *fasik* (i pabindur, rebel). Sa i përket atij që gjykon sipas asaj që Allahu shpalli në çështjet që i takojnë tewhidit dhe lënies së shirkut, por ai nuk gjykon me ligje të caktuara që Allahu shpalli, atëherë vendimi i këtyre ajeteve nuk janë medoemos të zbatueshme në rastin e tij'.

Dijetarët kanë thënë:

'E tërë kjo vlen për personin i cili me vetëdije dhe qëllimisht refuzon një gjykim të qartë të Allahut, jo për personin i cili s'është i vetëdijshëm për atë gjykim apo që gabon në interpretimin e tij'.

Në *Zād el-Mesir*, Ibn el-Xheuzi thotë:

"Për kë janë shpallur këto ajete? Dijetarët dallojnë lidhur me përgjigjen në këtë pyetje dhe, lidhur me këtë, dallohen pesë qëndrime:

- 1) Këto u shpallën veçanërisht për çifutët. Ky qëndrim përcillet nga Ubejd ibn Abdullah, nga Ibn Abas. Dhe Katade, po ashtu, e shprehu këtë qëndrim.
- 2) Këto u shpallën për muslimanët. Se'id ibn Xhubejr transmeton një qëndrim nga Ibn Abas që pak a shumë bart këtë kuptim.
- 3) Këto ajete kanë karakter të përgjithshëm dhe vlejnë si për çifutët, ashtu dhe për pjesëtarët e këtij umeti. Këtë qëndrim e shprehën Ibn Mes'ud, el-Hasen, en-Nekhe'i dhe es-Siddi.
- 4) Këto u shpallën për çifutët dhe të krishterët. Këtë qëndrim e shprehu Ebu Muxhliz.
- 5) Nga tri ajetet, i pari u shpallë për muslimanët, i dyti për çifutët, dhe i treti për të krishterët. Këtë qëndrim e shprehu esh-Sha'bi.

Sa i përket domethënies së menduar të kufrit në ajetin e parë, ka dy mendime:

- 1) Kjo i referohet kufrit (mosbesimit) në Allahun
- 2) Kjo i referohet kufrit në gjykimin e veçantë që nuk zbatohet. Prej këtui, kjo nuk është kufr që të qetë prej fesë.

Kjo në vijim është qëndrimi i saktë (lidhur me të gjitha çështjet e mësipërme): Kushdo që nga mosbesimi nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ndonëse e di se Allahu e ka shpallur atë – dhe këtë e bënë çifutët -, ai është qafir (mosbesimtar). Dhe, kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli jo nga mosbesimi, por nga animi për të ndjekur dëshirat personale, atëherë ai është *dhālim* (keqbërës) dhe *fāsik* (i pabindur, rebel)".

Ibn Kethir tha në Tefsirin e Tij:

"Sa i përket ajetit '[Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ata janë qafira](#)', Ibn es-Siddi tha:

'Nëse personi nuk gjykon me atë që Allahu shpalli dhe nëse përmbahet nga kjo qëllimisht ... dhe me vetëdije të plotë, atëherë ai është qafir.'

Sa i përket ajetit të njëjtë, Ali ibn ebi Talha transmetoi nga Ibn Abasi se:

'Nëse personi refuzon atë që Allahu shpalli, ai bën kufr. Por, nëse personi e pranon atë që Allahu shpalli (ndonëse nuk e zbaton), ai është *dhālim* dhe *fāsik*'.

Ibn Xherir, i cili e përcolli këtë transmetim të fundit, zgjodhi qëndrimin se ajeti u referohet ithtarëve të Librit (çifutëve dhe të krishterëve) apo atyre që e refuzojnë gjykimin e Allahut që shpallet në Librin (Kuran). AbduRrezak transmeton nga eth-Theuri nga Zekerijeh, nga esh-Sha'bi se

'Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli' u adresohet muslimanëve. Ibn Xherir përcolli një transmetim tjetër nga esh-Sha'bi, ku ai thotë se: 'Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, janë qafira', u adresohet muslimanëve; 'Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ata janë *dhālimun*' u adresohet çifutëve; dhe 'Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, janë *fāsikun*' u adresohet të krishterëve.

AbduRezak transmeton nga Mu'amer, nga Tawus, nga babai i tij, i cili tha:

'Ibn Abas qe pyetur rreth thënies së Allahut 'Kushdo që nuk gjykon ...' dhe ai tha: 'Ai që e bën këtë, s'është si ai që mohon Allahun, engjëjt e Tij, Librat e Tij dhe të Dërguarit të Tij'.

Eth-Theuri transmetoi nga Ibn Xhurejxh se Atā tha:

'Kjo është kufr (mosbesim) i shkallës më të ulët sesa kufr (i madh), *dhulm* i shkallës më të ulët sesa *dhulm* (i njohur), dhe *fisk* i shkallës më të ulët sesa *fisk* (i njohur)'.

Sa i përket ajetit të parë 'Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ata janë qafira', Waki transmeton nga Se'id el-Mekki se Tawus tha:

'Kjo s'është kufr që të qetë prej fesë'.

Dhe lidhur me ajetin e njëjtë, Ibn ebi Hatim transmeton këtë thënie nga Ibn Abas:

'Nuk është kufri që ju po mendoni'.

El-Hakim transmetoi transmetimin e mëparshëm nga Sufjan ibn Ujejneh dhe tha:

'Është i vërtetë dhe përmbush kriteret e el-Buhari dhe të Muslim, ndonëse ata nuk e transmetuan'.

Në *Rûhul-Me'āni*, el-Alusi thotë:

"Ndoshta, atyre u janë dhënë këto tri përshkrime (kufr, *dhulm* dhe *fisk*) dhe secila është e përshtatshme për një aspekt të veprimit të tyre. Kështu, ngaqë ata refuzojnë (të gjykojnë me atë që Allahu shpalli), ata përshkruhen si qafira; ngaqë ata nuk gjykojnë si duhet, ata përshkruhen si *dhālimûn*; dhe ngaqë ata lanë të vërtetën, përshkruhen si *fāsikûn*. Apo, ndoshta, ata përshkruhen bazuar në fazat e refuzimit të tyre për të gjykuar (me atë që Allahu shpalli). Nganjëherë, refuzimi i tyre përfshin kufr, nganjëherë përfshin *dhulm* e *fisk*".

Ebu Humejd dhe të tjerët transmetuan se esh-Sha'bi tha:

"Nga tri ajetet në el-Ma'ideh, i pari është për këtë popull (muslimanët), i dyti është për çifutët, dhe i treti është për të krishterët."

Kjo sugjeron se besimtarët janë në një situatë më të rëndë sesa çifutët dhe të krishterët. Mirëpo, është thënë se, kur kufri i atribuohet besimtarëve, kjo është për të treguar shkallën e seriozitetit, kurse, kur fjalët *fisk* dhe

وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الظَّالِمُونَ ﴿٤٥﴾

dhulm u atribuohen qafirave, kjo është për të treguar paturpësinë dhe rebelimin e mosbesimit të tyre. Kjo mbështetet nga një transmetim, ku Ibn Abas thotë lidhur me kufrin që përmendet në të parin prej tri ajeteve:

“Nuk është kufri që po mendoni ju; nuk është kufri që të qetë prej fesë, por është kufr më i vogël se kufri (i madh)”. (Ibn el-Mundhir, el-Hakim, dhe el-Bejheki e përcolli këtë transmetim në *Sunen*-in e tij, dhe el-Hakim e cilësoi si të vërtetë)...

Disa dijetarë eminentë nga gjeneratat e vona thanë se kufri (mosbesimi) është ajo që mendohet edhe me dy ajetet e fundit; ata morën qëndrimin se këtu mendohet në *fisk* dhe *dhulm* të plotë (me siguri që kufri përfshihet në shkallët e larta të *fiskut* dhe *dhulmit*). El-Hakim, AbduRrezak dhe Ibn Xherir përrollën transmetimin në vijim nga Hudhejfe si të vërtetë: Tri ajetet u përmendën në prani të Hudhejfes dhe një burrë tha: ‘Këto u referohet bijve të Israilit’. Hudhejfe tha: ‘Sa vëllezër të mirë që janë bijtë e Israilit për ju! Çdo gjë të ëmbël doni ta lini për vete, kurse çdo gjë të hidhët ua lini atyre! Jo! Pasha Allahun, ju do të ndiqni rrugët e tyre aq sa dhe lidhësja e këpucëve (shprehje që nënkupton pasim të përafërt apo të saktë)’. Ndoshta kjo do të thotë se Hudhejfe anonte nga qëndrimi se këto kanë të bëjnë vetëm me muslimanët. Mundësia e parë është transmetuar nga Ali ibn el-Husejn (radi Allahu anhu), përveçqë ai shtoi në këtë transmetim:

“Kufri i cili s’është si kufri apo shirku, *fisk* i cili s’është si *fisku* i shirkut, dhe *dhulm* i cili s’është si *dhulmi* i shirkut”.

Dhe, ne fund, esh-Shenkiti (Allahu e pastë mëshiruar) tha në *el-Adwā el-Bejān*:

“Sa i përket kësaj teme, me qëllim që personi të kuptojë si duhet, është tepër me rëndësi që të dihet se fjalët kufr, *dhulm* dhe *fisk* në Sheriat nganjëherë përdorën me domethënien e gjynahut, nganjëherë me domethënien e kufrit që të qetë prej fesë. Pra, nëse personi nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, me nijetin e kundërshtimit të të Dërguarve dhe zhvlerësimin e urdhrit të Allahut, atëherë *fisku*, *dhulmi* dhe kufri i tij të gjitha janë kufr që të qesin prej fesë. Dhe, nëse personi nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ndonëse ai beson se po bën një vepër të ndaluar e të ligë, atëherë kufri, *dhulmi* dhe *fisku* i tij nuk e heqin atë prej fesë... Konteksti i këtyre ajeteve në Kuran tregon se ajeti i parë është për muslimanët, i dyti për çifutët dhe i treti për të krishterët. Megjithatë, ne duhet të kemi parasysh karakterin e përgjithshëm të nënkuptimeve të fjalëve, jo arsyet e veçanta që i shkaktuan ato (kështu që, edhe nëse një nga këto ajete është për çifutët, edhe ne, po ashtu, duhet të kemi kujdes) ... (Dhe Allahu e di më së miri)”.

“Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ata janë *dhalimûn* (idhujtarë dhe keqbërës)”. (el-Ma’ideh, 45)

وَمَنْ لَّمْ يَحْكَمْ بِمَا أَنزَلَ اللَّهُ فَأُولَٰئِكَ هُمُ الْفَاسِقُونَ ﴿٤٥﴾

“Kushdo që nuk gjykon me atë që Allahu shpalli, ata janë *fasikûn* (rebelë, të pabindur)”. (el-Ma’ideh, 47)

أَلَمْ تَرَ إِلَى الَّذِينَ يَزْعُمُونَ أَنَّهُمْ ءَامَنُوا بِمَا أَنزَلَ إِلَيْكَ وَمَا أَنزَلَ مِنْ قَبْلِكَ يُرِيدُونَ أَن يَتَحَاكَمُوا إِلَى الطَّاغُوتِ وَقَدْ أُمِرُوا أَنْ يَكْفُرُوا بِهِ ۚ وَيُرِيدُ الشَّيْطَانُ أَنْ يُضِلَّهُمْ ضَلَالًا بَعِيدًا ﴿٤٦﴾

“A nuk i ke parë ata (hipokritët) që pohojnë se besojnë në atë që t’u shpall ty dhe në atë që u shpall para teje, dhe duan që mes tyre të gjykojë *Tagût* (gjykatësi i rremë, etj) ndërsa ata janë urdhëruar që t’i refuzojnë ata. Por, Shejtani do që t’i humbasë larg ata”. (en-Nisa, 60)

فَلَا وَرَبِّكَ لَا يُؤْمِنُونَ حَتَّىٰ يُحَكِّمُوكَ فِيمَا شَجَرَ بَيْنَهُمْ ثُمَّ لَا يَجِدُوا فِي أَنفُسِهِمْ حَرَجًا مِّمَّا قَضَيْتَ وَيُسَلِّمُوا تَسْلِيمًا ﴿٦٥﴾

“Por, jo, pasha Zotin tënd, ata s’mund të besojnë, derisa të bëjnë ty (O Muhamed) gjykatës në të gjitha mospajtmet mes tyre dhe më pas të mos ndjejnë kurrfarë kundërshtie ndaj vendimeve tua dhe t’i pranojnë ato më nënshtrim të plotë”. (en-Nisa, 65)

Urweh (radi Allahu anhu) transmetoi incidentin që u bë shkak për zbritjen e ajetit të fundit. Ai tha:

”ez-Zubejr u grind me një burrë nga Ensarët lidhur me një përrua që vinte nga el-Hirreh (vend i mirënjohur në Medine).⁷ Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha (kur gjykoi):

‘Vadite (tokën tënde), o Zubejr, pastaj lëre ujin të rrjedhë tek fqinji yt’ (Toka e Zubejrit gjendej më afër burimit të ujit, kështu që ky ishte gjykimi më i drejtë, i cili, po ashtu, kishte parasysh nevojat e fqinjit Ensar të Zubejrit). Ensari tha: ‘O i Dërguar i Allahut, (gjykove kështu) vetëm pse është kushëriri yt!’ Pejgamberit iu skuq fytyra nga hidhërimi dhe tha: ‘Vadite ujin, o Zubejr, pastaj ndale ujin, derisa të kthehet në burimin e kopshtit, pastaj lëre ujin të rrjedhë tek fqinji yt’. Para se ta hidhëronte Ensari, pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) bëri një zgjidhje që ishte në dobi të dy palëve, por pastaj (pasi që Ensari e hidhëroi), pejgamberi i dha Zubejrit të drejtë e plotë të tij me një vendim të prerë (ishte e drejtë e plotë meqë toka e tij ishte më së afërti burimit të ujit). Ez-Zubejr tha: ‘Mendoj që ky ishte incidenti që u bë shkak i shpalljes së këtyre ajeteve: ‘Por, jo, pasha Zotin tënd, ata s’mund të besojnë, derisa të bëjnë ty (O Muhamed) gjykatës në të gjitha mospajtimet mes tyre’”.⁸

⁷ Në arabisht, el-Harrah i referohet një toke që ka gurë të zinj me bollëk dhe që janë të prishur deri në atë masë, saqë duket se janë djegur nga zjarri.

⁸ Transmetuar nga el-Buhari (4585) dhe Muslim (2357).

Gjykimi me atë që Allahu shpalli në të gjitha çështjet

Tekstet e shpallura që na urdhërojnë të gjykojmë sipas asaj që Allahu i plotfuqishëm shpalli, janë të përgjithshme në atë se përfshijnë çdo gjë, çdo çështje dhe situatë. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) tha:

"Kushdo që të shohë një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e vet. Nëse s'ka mundësi ta bëjë këtë, atëherë me gjuhën e vet. Nëse s'ka mundësi ta bëjë këtë, atëherë me zemrën e vet, dhe kjo (ndryshimi me zemër) është imani (besimi) më i dobët"⁹.

Muslimani duhet ta largojë të keqen që e sheh dhe në të bërit e kësaj ai duhet të veprojë sipas tri niveleve që i përmendëm. Ai s'duhet të zgjedhë, duke larguar vetëm disa të këqija, por, sipas mundësisë, ai duhet të largojë çdo të keqe që sheh. Kryerja e veprave të këqija dhe e bidateve, ndalimi i çështjeve të lejuara si dhe çështjeve të ndaluara që bëhen të lejuara – këto janë gjëra të liga që muslimani duhet t'i largojë.

Thjesht për shkak se një person thërret të tjerët të gjykojnë me atë që Allahu shpalli në nivel shoqëror, s'do të thotë se ai është i arsyetuar nga detyra e largimit të të këqijave të lartpërmendura.

Kur një popull të kultivojë akte bindjeje ndaj Allahu të madhëruar midis pjesëtarëve të tij, do të arrijë lumturinë në dy botët – lumturinë e kalifatit në tokë dhe lumturinë e Xhenetit në Ahiret. Allahu i lartësuar thotë:

إِنَّ اللَّهَ لَا يُغَيِّرُ مَا بِقَوْمٍ حَتَّى يُغَيِّرُوا مَا بِأَنْفُسِهِمْ ۚ

⁹ Muslim (49).

"Vërtet, Allahu nuk e ndryshon gjendjen e mirë të një populli për sa kohë që ata nuk e ndryshojnë gjendjen e tyre (duke bërë gjynahe)". (er-Rad, 11)

Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha:

"Kur të bëni *Inā* (tregti me kamatë), të kapeni për bishtin e lopës (të preokupoheni me çështjet e dunjasë), të merreni me bujqësi/blegtori dhe të lini xhihadin, Allahu do t'ju poshtërojë dhe Ai nuk do ta largojë këtë, derisa t'i ktheheni fesë tuaj"¹⁰.

Në këtë hadith, i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) përmend shkaqet e poshtërimit dhe të disfatës, dmth tregtinë me kamatë dhe të qenit të preokupuar me bujqësi/blegtori (dhe me çështje të dunjasë në përgjithësi) në vend të xhihadit në rrugë të Allahut të madhëruar.

Këto janë shkaqet e disfatës. Por, cili është ilaçi?

A duhet të vazhdojmë të bëjmë tregti me kamatë (dhe të tjera transaksione të ndaluara)?

A duhet të mbetemi të paditur rreth fesë sonë?

Nëse dikush i thotë dikujt të mos bëjë tregti me kamatë, a duhet t'i thuhet këtij se po stërhollon pa nevojë për një detaj të vogël dhe se nuk ka kaptuar gjërat?

Por, a nuk është poshtërimi ynë i vazhdueshëm rezultat i tregtisë me kamatë dhe i transaksioneve tjera të ndaluara?

Për sa kohë që të vazhdojmë të bëjmë tregti në këto mënyra që Allahu i ka ndaluar, ne s'do të jemi në gjendje të largojmë

¹⁰ Transmeton Ebu Daud (*Sahi Sunen Ebu Daud* 2956); el-Bejheki në *Sunen el-Kubra* dhe nga et-Taberani dhe nga të tjerët, siç është përmendur nga shejhu jonë (Albani, Allahu e pastë mëshiruar) në *es-Silsileh es-Sahihah* (11).

poshtërimin që na ka kapluar. Ilaçi për mjerimin tonë është i qartë: "... derisa t'i ktheheni fesë suaj".

Në shpjegimin e termi *Rabbāijjun* te ajeti "Jini *Rabānijjun*" (Al Imran, 79), Ibn Abas tha:

"(Këta janë) Dijetarët që kuptojnë (fenë)".

Dhe është thënë se el-*Rabbani* (njëjesi i *Rabānijjun*) është një person i cili i edukon dhe i mëson njerëzit në çështjet e qarta para se t'ua mësojë çështjet e holla apo të vështira të fesë¹¹.

Synimi i një personi i cili ua mëson të tjerëve akiden, teuhidin dhe Emrat e Cilësitë e Allahut duhet të jetë që t'u sjellë dobi nxënësve të tij duke i pastruar besimet e tyre, krahas të kuptuarit se ai po hedh themelet e ndërtesës së ligjit islamik (gjykimit me atë që Allahu shpalli).

Kur personi fal namaz, ai duhet të falet me sinqeritet, pa menduar se vepra e tij është e parëndësishme për synimin e vendosjes së ligjit të Allahut (Sheriatit); bile, kjo dhe të tjera

¹¹ Buhari përmend këtë në *Mu'alleken* e tij, por me një formulim që shfaq një ndjenjë sigurie (*Kitab el-Ilm, Bab el-Ilm Keblel-Kaul uel-Amel*). El-Hafidh tha në *el-Fet'h* (1/161):

"Thënia (e Ibn Abasi) përcillet me një zinxhir të vazhdueshëm *hasen* nga Ibn ebi Asim. El-Khatib e përcjell këtë me një zinxhir tjetër që, po ashtu, është *hasen*. Ibn Abas e interpretoi *er-Rabbani* si një person që është i urtë dhe ka erudicion rreth fesë. Ibrahim el-Harbi përcjell se Ibn Mes'ud u pajtua me Ibn Abasin lidhur me interpretimin e termi *er-Rabbani*. El-Esma'i dhe el-Isma'ili thanë që *er-Rabbaani* është i lidhur ngushtësisht me fjalën *er-Rabb* (Zoti), sepse një person i cili është *Rabbānij* është ai, që me veprat dhe dijen e tij kërkon dhe mundohet të zbatojë atë çka *er-Rabb* (Zoti) urdhëroi. The'leb tha: 'Dijetarët quhen *Rabbānijjun*, sepse ndërmarrin detyrën e ruajtjes dhe përhapjes së dijes'. Prej këtui, ka mospajtime lidhur me atë nëse termi ka si rrënjë fjalën *er-Rabb* apo në fjalën *Terbijjeh* (edukim)... Dhe Ibn el-Arabi tha: 'Një dijetar nuk quhet *Rabbānij*, derisa të jetë dijetar që mëson dhe zbaton (atë që e di)'".

vepra të mira janë tulla individuale që bëhen bashkë për të kompletuar strukturën.

Ngjashëm, personi duhet të kuptojë se, duke ndjekur saktësisht Sunetin e pejgamberit, ai po bën një hap drejt vendosjes së ligjit të Allahut të lavdishëm në tokë.

Në këtë drejtim, ne s'duhet të jemi indiferent ndaj faktit se shumë ajete Kuranore qenë shpallur para themelimit të Shtetit islamik. Në ato ajete, Allahu fuqimadh e urdhëroi të Dërguarin e Allahut (salallahu alejhi ue selam) të paralajmëronte (të tjerët për Ditën e Gjykimit), të falte namaz nate, dhe të bënte gjëra të ngjashme.

Sigurisht që Allahu i patëmeta është në gjendje të lejojë formimin e një shteti islamik pa të gjitha këto, kështu që duhet të kuptojmë se ekziston një mënyrë e caktuar sipas së cilës gjërat zhvillohen apo, nëse do (t'i quash), masa paraprake në shtegun e vendosjes së ligjit dhe Sheriatit të Allahut në vend...

Dëgjueshmëri dhe nënshtrim i plotë

Duke reflektuar në tregimin e Ibrahimit (alejhi selam) i cili, në përgjigje të urdhrit të Allahut fuqiplotë, la gruan dhe fëmijën e tij në një vend pa njerëz dhe ujë, personi duhet të mësojë shumë mësim të rëndësishme. Në përgjigje të urdhrit të Allahut, Ibrahim la gruan dhe fëmijën e tij në një tokë të shkretë e jopjellore. Ai nuk argumentoi duke thënë: "Çfarë urtësie dhe dobie ka në këtë?", por, në vend të kësaj, ai u ngut të përgjigjej urdhrit të Zotit të tij.

Ibn Abas (radi Allahu anhu) transmetoi këtë hadith:

"Kur zunë vend disa ndodhi mes Ibrahimit (alejhi selam) dhe gruas së tij (Sarës), ai u largua me Ismailin (alejhi selam) dhe me Haxheren, të cilët kishin me vete një pagur me ujë. Nëna e Ismailit nisi të pinte nga paguri dhe më pas qumështi i rridhte me bollëk për fëmijën e saj. Kur Ibrahim mbërriti në Meke, ai e vendosi atë nën një lis të madh. Pastaj Ibrahim u nis për t'iu kthyer familjes së tij, por ajo (Haxherja) e ndoqi atë deri kur mbërritën Kedânë, ku ajo thirri nga prapa:

- O Ibrahim, kujt po na lë këtë?"
- (Po ju lë nën kujdesin e) Allahut", tha ai.
- Jam e kënaqur me Allahun – ia ktheu ajo.

Ajo u kthye dhe nisi të pinte nga paguri i saj dhe qumështi i rridhte me bollëk për fëmijën e saj. Kur u harxhua uji, ajo tha: "Nëse kërkoj përreth, ndoshta do të gjejë dikë". Kështu, ajo shkoi, u ngjit në *el-Safa* (një kodër e mirënjohur në Meke) dhe shikoi prapë me shpresë se do të shihte ndokënd, por ajo nuk pa njeri. Pastaj, kur mbërriti luginën, ajo lëvizte shpejt, derisa mbërriti *el-Merweh* (një tjetër kodër e mirënjohur në Meke). Ajo bëri disa turne në këtë mënyrë (mes *es-Safa* dhe *el-Merweh*) dhe tha: "Më duhet të shkoj të shoh se ç'bëri fëmija (dmth të shoh se çka i ndodhi)". Ajo shkoi dhe e gjeti atë në një gjendje ku ai dukej të merrte frymë shpejt, për shkak të afrimit të vdekjes. Ajo u shqetësua shumë dhe tha: "Nëse shkoj dhe shoh, ndoshta do të gjej ndokënd". Kështu, ajo u largua dhe u ngjit në *el-Safa* dhe shikonte vazhdimisht, por s'shihte njeri. Ajo vazhdoi të shihte, derisa përmbushi shtatë

(turne mes *el-Safa* dhe *el-Merweh*), pastaj tha: "Më duhet të shkoj të shoh se ç'bëri ai (duke iu referuar fëmijës)", dhe, papritmas, ajo dëgjoi një zë. Ajo tha: 'Më ndihmo, nëse ke ndonjë mirësi (të ofrosh)'. Ky ishte Xhibrili (alejhi selam), i cili bënte kështu me thembrën e tij - dhe ai i ra tokës me thembër. Uji shpërtheu dhe nëna e Ismailit u mahnit".

Ibn Abas tha: "Ajo nisi të ngutej, dhe Ebul-Kasim (dmth pejgamberi) tha: '**Sikur ta linte (të buronte pa u ngutur), uji do të vërshonte sipërfaqen e tokës**'. Ajo nisi të pinte nga uji dhe qumështi nisi t'i rridhte më bollëk për fëmijën e saj. Pastaj njerëzit nga Xhurhumi kaluan aty pranë nga mesi i luginës, kur dhe panë një shpend. Ata mezi po besonin çfarë po shihnin (Meka ishte e shkretë dhe prania e shpendit tregonte se aty kishte ujë), dhe thanë: 'Shpendi gjendet vetëm mbi (apo afër) ujë'. Kështu, ata nisën të dërguarin e tyre për të parë. Meqë ata gjendeshin afër ujit (burimit të Zemzemit), ai u kthye dhe i informoi rreth kësaj. Ata shkuan te ajo (Haxherja) dhe thanë: 'Oj nëna e Ismailit, a po na lejon të rrimë me ty – apo të jetojmë me ty?' (Ata u vendosën aty dhe) Kur biri i saj mbërriti pubertetin, u martua me një nga gratë e tyre. Ibrahimit i erdhi ndërmend (të vizitonte familjen) dhe i tha gruas së tij (Sarës): 'Do të shkoj t'i shoh ata që i lash mbrapa (në Meke)'. Ai shkoi dhe përshëndeti me selam (gruan e Ismailit) dhe tha: "Ku është Ismaili?" Ajo tha: "Doli për gjah". Ai tha: "Thuaji kur të vijë: Ndërroje pragun e derës tënde". Kur Ismaili i kthye, ajo e njoftoi për atë që kishte ndodhur. Ai (Ismaili) tha: 'Ai (Ibrahimi) po mendonte në ty, kur tha 'Ndërroje pragun e shtëpisë tënde', kështu që kthehu te familja jote (dmth po divorcohem)'. Pastaj, më vonë, Ibrahimit i lindi ideja dhe i tha gruas së tij (Sarës): 'Do të shkoj t'i shoh ata që i lash mbrapa'. Ai erdhi dhe tha: 'Ku është Ismaili?' Gruaja e Ismailit (meqë ai ishte martuar prapë) tha: 'Doli për gjah. A s'do të rrish të hash e të pish?' Ai (Ibrahimi) tha: 'Çka keni nga ushqimi dhe pija?' Ajo tha: 'Ushqimi jonë është mishi dhe pija jonë është uji'. Ai tha: 'O Allah, bekoi ata në ushqimin dhe në pijen e tyre'. Në këtë pikë në transmetim, Ibn Abas tha se Ebul-Kasim (dmth pejgamberi) tha: 'Bekime nëpërmjet lutjeve të Ibrahimit (dmth ka bekime në Meke, për shkak të kësaj lutje)'. Pastaj, më

vonë, Ibrahimit i lindi ideja, kështu që i tha gruas së tij (Sarës): 'Do të shkoj t'i shoh ata që i lash (në Meke)'. Ai erdhi dhe (kësaj here) takoi Ismailin prapa pusit të Zemzemit, ku ai po ndreqte shigjetat e tij. Ibrahim tha: 'O Ismail, vërtet që Zoti yt më urdhëroi të ndërtoj një shtëpi për Të'. Ismaili tha: 'Dëgjo Zotin tënd'. Ai (Ibrahimi) tha: 'Do ta bëjë këtë', apo fjalë të ngjashme. Pastaj Ibrahim nisi ta ndërtonte dhe Ismaili i jepte gurët ndërsa të dytë thoshin:

وَإِذْ يَرْفَعُ إِبْرَاهِيمُ الْقَوَاعِدَ مِنَ الْبَيْتِ وَإِسْمَاعِيلُ رَبَّنَا تَقَبَّلْ مِنَّا إِنَّكَ أَنْتَ السَّمِيعُ الْعَلِيمُ

'Zoti ynë, prano prej nesh. Vërtet, Ti dëgjon gjithçka, di gjithçka'. (el-Bekare, 127)"¹²

Bashkëshortja (Haxherja) e Ibrahimit (alejhi selam) e pyeti atë: "Kujt po na lë këtu?" Në disa transmetime të Buhariut, ajo vazhdimisht e përsëriti këtë pyetje apo kërkesë, por ai nuk u kthye për t'iu përgjigjur asaj. Më në fund, ajo tha:

- A të urdhëroi Allahu për këtë?
- Po - iu përgjigj ai (alejhi selam).
- Atëherë, Ai s'do të na lë të humbasim (zhdukemi) - tha ajo.

Në një tjetër transmetim, ajo tha: "Jam e kënaqur me Allahun (dmth me caktimin e Tij dhe përkujdesjen e Tij)". Dhe ajo nuk tha: "Ka punë tjera më me përparësi sesa të na lësh në këtë vend të shkretë. Na merr me vete, se ne mund të të ndihmojmë të thërrasësh të tjerët në rrugën e Allahut".

Nëse na bëhet e ditur se një urdhër është nga Allahu i patëmeta, ne duhet të bëjmë vetëm atë që bëri nëna e Ismailit: dëgjoji dhe u bind. Duke qenë e kënaqur me caktimin e Allahut, ajo nisi të endej shpejtas andej-këtej nga *el-Safa* në *el-Merwe* herë me shpresë se do të gjente ujë, herë nga tuta për të birin e saj, i cili ishte buzë vdekjes.

¹² Transmetuar nga el-Buhari (3365).

Ata që kanë besim të pakët, mund të thonë: “Po kjo fatkeqësi gati sa nuk e vrau fëmijën! Çfarë dobie i solli kjo atij, babait të tij e nënës së tij?!”. Njerëzit e këtillë nuk e çmojnë xhihadin, durimin dhe sakrifikimin e Ibrahimit (alejhi selam) dhe të familjes së tij. Njerëzit e këtillë mbajnë pikëpamje krejtësisht materialiste, mu atë pikëpamje që ka përplasur umetin tonë.

Nga pikëpamja reale dhe e arsyeshme, le të pyesim se cilat ishin rezultatet e bindjes së Ibrahimit dhe të bashkëshortes së tij ndaj Allahut të lartësuar?

Ato kanë qenë rezultate që janë korrur jo vetëm nga Ibrahim (alejhi selam), bashkëshortja e tij dhe fëmija e tij, por janë rezultate që çdo monoteist islamik në faqen e dheut i ka korrur dhe do të vazhdojë t’i korrë, deri në ardhjen e Çastit.

Muslimanët vijnë në Meke në turma nga Lindja e nga Perëndimi. Ata janë të lumtur e të kënaqur, ngaqë qarkullojnë mes Safasë dhe Merwes, mu në vendin ku nënë e Ismailit qarkulloi. Ata vijnë nga vende të largëta, me qëllim që të ushtrojnë vetveten për t’iu bindur urdhreve të Allahut. Ndërsa lëvizin shpejtas mes dy kodrinave, ata reflektojnë sesi nëna e Ismailit ende shpejtas andej-këtej në një gjendje dhimbjeje e mërzie, duke i dhënë përparësi bindjes ndaj Zotit të saj ndaj çdo gjëje tjetër.

Pastaj, me lejen e Allahut, buroi uji i Zemzemit, një ujë që përmban shërim për sëmundje dhe që është i bekuar. Deri në ditët e sotme, muslimanët kanë qenë të paduruar për të pirë aq sa munden nga po ai ujë dhe ta bartin në vende e tyre, pavarësisht largësisë dhe vështirësisë në këtë.

Ibrahimi (alejhi selam) ndërtoi Shtëpinë e Shenjtë. Shpërblimi për faljen e namazit aty është shumëfish më i madh se falja kudo. Njerëzit, gjithashtu, arrijnë shpërblime për bërjen e tawafit rreth Qabes, ndërsa lutjet e tyre u pranohen. Këto janë dobitë që shtrihen përtej atyre që dëgjuan te ata që erdhën mbas tyre.

Pra, le t'i bindemi Zotit tonë, edhe nëse kjo në dukje përfshin pak lodhje, vështirësi, bile dhe vdekje. Le ta ndalojmë vetveten nga mosbindja e mosrespektimi. Atëherë, a nuk do të reflektojmë mbi këtë?

Një rrëfim i ngjashëm mund të gjendet në rastin e nënës së Musës (alejhi selam), kur, me urdhrin e Allahut të patëmeta, ajo hodhi fëmijën e saj në lum:

"Dhe Ne frymëzuam nënën e Musës duke i thënë: 'Jepi gji (Musës), por, kur të tutesh për të, hidhe në lum e mos u tut as mos u mërzit. Vërtet, Ne do të ta kthejmë prapë atë dhe do ta bëjmë ndër të Dërguarit'". (el-Kasas, 7)

Kur Allahu i madhëruar e urdhëroi nënën e Musës të hidhte fëmijën e saj në lum, ajo mundi vetëm t'i bindej. Sikur ajo të shihej nga dikush që nuk i njihte rrethanat në të cilat gjendej ajo, veprimi i saj do të dukej si i shtyrë nga një krizë çmendurie, meqë çfarë dobie do t'i sillte asaj apo Musës (alejhi selam) hedhja e tij në lum? Megjithëkëtë, në fund, dobitë e veprimit të saj ishin përtej çfarëdo që një person do të mund të imagjinonte. Ngaqë ajo iu bind urdhrin të Allahut, fëmija i saj iu kthye shëndosh e mirë. Ajo u shpëtua nga mërzia dhe, në vend të kësaj, u kënaq, duke ditur se premtimi i Allahut është i vërtetë. Dhe biri i saj, Musa (alejhi selam) u bë ndër "[Të Dërguarit vullnetfortë](#)" (el-Ahkaf, 35)

Kur të thuhet të bësh diçka, mos thuaj: "Çfarë dobie ka në këtë?", por thuaj: "A më urdhëroi Allahu ta bëj këtë? A më ka urdhëruar i Dërguari (salallahu alejhi ue selam) ta bëj këtë? A ka dëshmi nga Shpallja lidhur me këtë?"

Në fund të fundit, lumturia jonë qëndron në bindjen ndaj Allahut të lartësuar, edhe pse, me sa duket, disa akte të bindjes ngërthejnë njëfarë shkalle të lodhjes e të vështirësisë. Në anën tjetër, mjerimi i plotë dhe i vërtetë gjendet në largimin nga urdhrat e Allahut, edhe nëse, në dukje, veprimi i tillë ofron një jetë të rehatshme dhe lumturi në këtë botë.

Njeriu bën mirë të reflektojë mbi arsyet përse rrëfimet si këto janë përcjellë në Kuran dhe në Sunet. Ato nuk janë përcjellë për t'u argëtuar, por për të shërbyer si kujtim dhe për të forcuar zemrat e besimtarëve:

"Dhe krejt ajo që po ta përcjellim (O Muhamed) nga lajmet e të Dërguarve është me qëllim që të ta përforcojmë zemrën".
(Hud, 120)

Prioritetet¹³

Së pari, sado e rëndësishme apo e madhe të jetë një gjë, ajo është një pjesë e një tërësie apo një degë e bazës; tërësia përbëhet nga pjesët dhe baza degëzohet. Bile, dhe shehadeti është pjesë e dy shehadeteve (se s'ka të denjë për adhurim pos Allahut, dhe Muhamedi është i Dërguari i tij). Unë tash do të shpjegoj më tej këto parime.

Arritja e një shoqërie muslimane që qeveriset nga kalifi musliman është dëshira e zjarrtë e çdo muslimani me mendje të shëndoshë. Megjithëkëtë, një person i cili thjesht vetëm e dëshiron që kjo të ndodhë, ka qejf të jetojë në një kështjellë të madhe e cila pritet të ndërtohet. Së pari, toka ku do të ndërtohet kështjella duhet të mihet thellë; themelet duhet të jenë të forta e të qëndrueshme. Kur dheu të jetë duke u mihur, a do të thoshte një person me mendje të shëndoshë "Përse po mih teposhtë kurse do të ndërtosh përpjetë? Ti po e vonon ndërtimin e kështjellës!" Jo, ai s'është i arsyeshëm, sepse ai e do tërësinë (apo rezultatin përfundimtar) pa zhvillimin e pjesëve. Duke parë sasi të e hekurit në një vend, sasi të e tullave dhe të cementit në vendin tjetër, si dhe sasi të e drurit në vend tjetër, ai vajton: "Çka

¹³ Parimi i cili thotë se "Çështjeve më të rëndësishme duhet t'u jepet përparësi ndaj çështjeve të rëndësishme", është i vërtetë dhe s'duhet të injorohet. Mirëpo, ne nuk duam që ky parim të përdoret kundër atyre që mundohen të bëjnë punë të mira, meqë kjo do të çojë në lënien e çështjeve më të rëndësishme dhe të rëndësishme, të çështjeve parësore dhe atyre dytësore. Krejt çka do të mbetet do të jetë llaf dhe slogane. Për më shumë, nëse ka pengesa që na pengojnë të zbatojmë çështjet më të rëndësishme, a duhet që ne t'i lëmë çështjet e rëndësishme që mund t'i zbatojmë? Vërtet, zbatimi i çështjeve të rëndësishme do të trasojë rrugën për zbatimin e çështjeve më të rëndësishme më vonë. Interesimi ynë kryesor gjithmonë duhet të jetë frika ndaj Allahut të madhëruar aq sa të kemi mundësi. Pastaj, nëse gjendja jonë kufizohet deri në atë masë sa të mund të zbatojmë vetëm një çështje, ne duhet t'i japim përparësi çështjes më të rëndësishme ndaj çështjes së rëndësishme, të obligueshmes ndaj të vullnetshmes.

na duhet ky hekur, këta drurë e këto tulla për ndërtimin e kështjellës?" Por, nëse i mbledhim këto pjesë të shpërndara së bashku me pjesë tjera, ne mund të ndërtojmë një kështjellë të madhe dhe të realizojmë shpresat dhe dëshirat tona.

Kështu qëndron puna me "detajet e parëndësishme" apo "çështjet sekondare". Sikur të këqyrje në secilën vepër veç e veç, do të ndjeje shtytje që ta nënçmoje dhe të thoshe: "Çfarë do të kontribuonte kjo në ndërtimin e shoqërisë muslimane dhe në vendosjen e ligjit të Allahut në tokë?"

Duke marrë pjesë në një orë mësimi rreth teuhidit (monoteizmit islamik), duke dhënë një sasi të pakët si sadaka, duke i falur dy rekate namaz, duke bërë ndonjë punë bujare, duke i urdhëruar të tjerët të bëjnë mirë dhe duke i ndalur ata nga e keqja apo bidati, ti mund të mendosh: "Këto janë copa të shpërndara që as nuk mund të shembin bazat e një shoqërie injorante, as të themelojnë strukturën e një shoqërie islamike". Por, nëse i kombinon këto pjesë, do të kuptosh se këto përbëjnë tërësinë dhe se tërësia përbëhet prej tyre. Veprat e lartpërmendura si dhe të tjerat janë pjesë të ndërtesës që është shoqëria muslimane.

Sa lehtë është të flasësh rreth përgjithësisë dhe plotësisë se fesë Islame! Natyrisht që ne nuk duhet t'i nënçmojmë ata që flasin me dije rreth karakterit gjithëpërfshirës të islamit apo për ata që theksojnë vendosjen e ligjit të Allahut (shariatit), meqë ky është synimi i çdo muslimani. Mirëpo, të flasësh rreth karakterit gjithëpërfshirës të Islamit dhe rëndësisë së vendosjes së ligjit të Allahut nuk duhet të na pengojë që vazhdimisht të kryejmë veprat të cilat kemi mundësi t'i kryejmë. Them që është lehtë të flasësh rreth karakterit gjithëpërfshirës së Islamit, sepse një injorant apo një fëmijë mund të flasë rreth kësaj, bile edhe para një të rrituri apo një dijetari. Kjo sepse thjesht vetëm të flasësh rreth ndërtimit të një kështjelle gjigande nuk e sjell atë në

ekzistencë, dhe thjesht vetëm të flasësh rreth karakterit gjithëpërfshirës të Islamit nuk e përgatit një vend për zbatimin e tij. Pra, le të përqafojmë të gjitha aspektet dhe pjesët e fesë – dijen, veprimin, sinqeritetin, durimin, angazhimin dhe qëndrueshmërinë.

Ne, gjithashtu, duhet të kemi kujdes të rikujtojmë se pjesët e një tërësie nuk qëndrojnë të pavarura; ato të gjitha janë të lidhura në tërësinë mu sikurse degët që s'janë të pandara, por të lidhura me themelin apo trungun.

Është më se e vërtetë që, sikur të kishim një shoqëri të njëmendtë muslimane që qeveriset nga ligji i Allahut (Sheriati) dhe që udhëhiqet nga një kalif fisnik, pjesë të ndryshme të shoqërisë – familje e individë – do të prosperonin me një vetëdije të shëndoshë islamike në teuhid, në fikh dhe në moral; ata do të ishin më të mirë në bashkëveprimet e tyre dhe në kryerjen e akteve të adhurimit. Si burrat, ashtu dhe gratë do të stoliseshin me veshje islamike, do të konsumonin ushqim e pije hallall, do t'i shmangeshin përzierjes së gjinive, dhe do t'i përmbushnin detyrimet tjera fetare.

Por, nëse s'ka kalif musliman, a mundemi ne t'i realizojmë të gjitha këto apo se paku disa nga çështjet që u përmendën? Vërtet, është përgjegjësi e çdo kujdestari apo, nëse do, e çdo pushtetari më të vogël që ta edukojë dhe trajnojë vetveten, fëmijët e tij dhe të gjithë ata në të cilët ka mundësi të ndikojë.

Kërkoj shpëtim tek Allahu që të them fjalë që nënçmojnë rëndësinë e kalifatit musliman. Prania e tij ka një ndikim të pamasë në ndryshimin e gjendjes së shoqërisë. Por, këtu po flas rreth një personi që thotë se duhet lënë aspekte të caktuara të fesë meqë s'ka sundimtar musliman. Ai pohon se këto aspekte fetare e tërheqin vëmendjen nga themelimi i Sheriatit të Allahut.

E vërtetë; ka gjëra të caktuara që s'mund të kryhen pa një pushtetar musliman, dhe kjo është diçka që s'mund ta anashkalojmë. Megjithëkëtë, ka çështje tjera që s'mund të arrihen pa luftuar personi kundra vetvetes, dhe kjo ndodh në nivel individual të të udhëhequrit, qytetarët.

Çdo person është përgjegjës dhe prijës

Ebu Hurejre transmetoi se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue salam) tha:

"Çdo person nga pasardhësit e Ademit, është përgjegjës. Burri është përgjegjës mbi familjen e vet dhe gruaja është përgjegjëse për shtëpinë e saj".¹⁴

Në një tjetër hadith, pejgamberi (salallahu alejhi ue salam) thotë:

"Secili prej jush është çoban dhe secili prej jush është përgjegjës për tufën e tij. Imami është çoban, përgjegjës për bashkësinë e tij. Burri është çoban, përgjegjës për tufën (familjen) e tij. Gruaja është çobanesh në shtëpinë e burrit të saj dhe përgjegjëse për tufën e saj. Shërbëtori është çoban i pasurisë së pronarit të tij dhe përgjegjës për tufën e tij ...".¹⁵

Pra, pavarësisht se a kemi një sundues musliman, apo jo, secili prej nesh është çoban, udhëheqës, përgjegjës, komandant, kujdestar në shtëpinë e vet, me përgjegjësi të mëdha të cilat duhet përmbushur.

Siç transmetohet në hadithin vijues, Islami është një numër dorezash (për të cilat duhet kapur):

"Dorezat (dmth mësimet dhe ligjet) e Islamit do të shkopsiten një nga një. Sa herë që një dorezë shkopsitet, njerëzit do të

¹⁴ Transmetuar nga Ibn el-Sinni në "Veprat e ditës dhe të natës" dhe nga të tjerët. Ky hadith është i vërtetë, të cilin shejhu jonë (Albani, Allahu e pastë mëshiruar) e shënon në *es-Sahih*a (2041) dhe thotë: "Ky është zinxhir i vërtetë, që përmbush kriteret e Muslimit".

¹⁵ Transmetuar nga el-Buhari (893) dhe Muslim (1829).

mbahen për tjetrën që e pason atë. E para që do të shkopsitet është *el-Hukm* (ligji islamik), kurse e fundit është namazi".¹⁶

Prandaj, Islami përbëhet nga pjesë të bëra bashkë. Më e rëndësishmja nga këto është ligji islamik që përbëhet nga namazi, zekati, haxhi, etj. Vetëm pse një musliman është i zënë me thirrjen e shoqërisë për të vendosur sheriatin e Allahut si një mënyrë jetese dhe si kushtetutë të vendit, ai s'është i arsyetuar nga detyra e zbatimit të sheriatit të Allahut në jetën e tij, mes familjes së tij dhe mes gjithë atyre në të cilët ka mundësi të ndikojë.

Këtë duhet kuptuar, sepse disa njerëz që, për shembull, i thërrasin të tjerët të përmirësojnë besimin dhe të ngritin nivelin e të kuptuarit, akuzohen për pengim të përpjekjeve të të tjerëve që përpiqen të vendosin sheriatin e Allahut në vend.

Në një tjetër shembull, ti mund të gjesh njerëz që irritohen, kur u thuhet të drejtojnë safat në namaz. Ata mund të thonë, për shembull: "S'duhet sot të merremi me këso gjëra". Por, nëse reflekton mbi urdhrin e peygamberit (salallahu alejhi ue selam) lidhur me këtë veprim, do të vish në një përfundim të kundërt. I Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) tha:

"Drejtoni (safat) e mos u dalloni (në trupat tuaj duke mos i drejtuar safat). Përndryshe, zemrat tuaja do të dallojnë".¹⁷

En-Nu'man ibn Beshir transmetoi se peygamberi (salallahu alejhi ue selam) tha:

"Ju do të drejtoni safat ose Allahu do të bëjë që fytyrat tuaja të dallojnë (dmth do të bëjë që armiqësia dhe urrejtja të zënë vend mes jush)".¹⁸

¹⁶ Transmetuar nga Muslim (432).

¹⁷ Transmetuar nga Muslim.

Në një tjetër transmetim, en-Nu'man bin Beshir tha:

"I Dërguari i Allahut u kthye me fytyrë nga njerëzit dhe tha: 'Ndreqni safat (duke i drejtuar dhe mbushur zbrazëtitat). Pasha Allahun, ju do t'i ndreqni safat ose Allahu do të bëjë që zemrat tuaja të dallojnë'.¹⁹

Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) qartë tha se mosndreqja e safave në namaz çon në mospajtime mes zemrave të njerëzve. Prandaj, gabojnë ata që thonë se të flasësh rreth rëndësisë së drejtimit të safave përçan zemrat e njerëzve dhe ua heq mendjen atyre nga mësimet më të rëndësishme të fesë.

Mospajtimi mes zemrave të njerëzve më pas çon në dështim, shkatërrim dhe humbje të fuqisë. Allahu i madhëruar thotë:

"Mos u grindni (me njëri-tjetrin) që mos të humbisni guximin dhe t'ju lë forca" (8:46)

Dhe i Dërguari i Allahu (salallahu alejhi ue selam) tha:

"Mos u dalloni mes vete, se, vërtet, ata që erdhën para jush, u dalluan dhe më pas u shkatërruan".²⁰

Nëse kombinojmë domethëniet e haditheve dhe ajeteve të lartpërmendura, mbetemi me këtë domethënie: Ndreqni safat dhe mos u dalloni (as në trupa tuaj, as në zemrat tuaja). Përndryshe, do të shkatërroheni, do të dështoni, forca do t'ju lë dhe armiqtë do t'ju mposhtin.

Ai që mendon se, nëse duam të vendosim sheriatin e Allahut në tokë, ne duhet të injorojmë ndreqjen e safave në namaz dhe të tjera mesele të ngjashme të fesë, është si personi që mendon se

¹⁸ Transmetuar nga el-Buhari (717) dhe Muslim (436).

¹⁹ Transmetuar nga Ebu Daud (*Sahih Sunen ebi Daud* 616), dhe nga Ibn Hibân i transmetuar në *Sahih* e tij.

²⁰ Transmetuar nga el-Buhari (2410).

namazi është më i rëndësishëm sesa agjërimi dhe gjithçka tjetër, kështu që i qorton ata që flasin rreth rëndësisë së agjërit apo ndalimit të transaksioneve të bazuara në kamatë. Të dy palët e kanë gabim, meqë veprat e obligueshme në fe janë aq sa dhe llojet e tyre, dhe nga muslimani kërkohet që t'i kryejë ato aq sa ka mundësi.

Prandaj, s'ka ndonjë arsye të pranueshme që të thuhet se disa detyra bien ndesh me disa tjera. Bërja e xhihadit në rrugë të Allahut është detyrë. T'i thërrasësh të tjerët në rrugë të Allahut është detyrë. Të bërit luftë kundër besimeve të rreme është detyrë. Të luftosh përhapjen e përgojimeve dhe sharjeve është detyrë. Të qenit në shërbim të prindërve është detyrë. Ndreqja e safave është detyrë. Muslimani, sipas mundësisë që ka, është përgjegjës për të gjitha këto detyra.

Kur dikush thotë se ka prioritete – detyrë më të rëndësishme dhe të rëndësishme -, ai flet të vërtetën. Mirëpo, ne duhet të dimë rreth prioriteteve jo për t'i lënë detyrat tjera, por me qëllim që të koordinojmë dhe klasifikojmë detyrat tona në mënyrë që të bëjmë garë në bamirësi.

Sepse për çdo çështje e cila është e rëndësishme ka një tjetër që është më e rëndësishme. Kjo, bile, vlen edhe për dy dëshmitë e besimit, meqë "Kurrkush s'është i denjë për adhurim, përveç Allahut", është më e rëndësishme sesa "Muhamedi është i Dërguar i Allahut".

Megjithëkëtë, prania e asaj që është më e rëndësishme nuk e zhvlerëson atë që është e rëndësishme. Vetëm atëherë kur situata vështirësohet dhe kufizohet personi mund të zbatojë vetëm njërin nga dy çështjet dhe do t'i jepte përparësi çështjes më të rëndësishme. Kjo është e ngjashme me rastin kur ne s'kemi kohë dhe i japim rëndësi veprës së obligueshme ndaj asaj të vullnetshme.

Në rrethana të tendosura, gjë që është rregull e jo përjashtim, ne duhet të mundohemi aq sa kemi mundësi të zbatojmë edhe çështjen e rëndësishme, edhe atë më të rëndësishme. Ne shkojmë me këtë në dritën e thënies së Allahut të madhërishëm:

لَا يُكَلِّفُ اللَّهُ نَفْسًا إِلَّا وُسْعَهَا

"Allahu nuk e rëndon një person përtej mundësive që ai ka".

(2:286)

Dhe në dritën e thënies së pejgamberit (salallahu alejhi ue selam):

"Kushdo pre jush që sheh një të keqe, le ta ndryshojë me dorën e vet. Nëse s'ka mundësi, atëherë me gjuhën e vet. Nëse s'ka mundësi, atëherë me zemrën e tij, dhe kjo (ndryshimi me zemër duke e urryer atë) është imani (besimi) më i dobët".²¹

Dhe ne nuk duhet të harrojmë parimin juridik: "Nuk lejohet vonimi i sqarimit (të një rregulli në ndonjë çështje) deri pas kohës së kërkuar".

Le të supozojmë se ti po dëgjon një person të përmendë një hadith të shpikur; a do ta vonosh informimin për gabimin e tij deri pasi që të zbatohet sheriati i Allahut si mënyrë jetese dhe si kushtetutë e vendit? A shpreson që vetëm atëherë ta informosh atë se para disa vitesh ai kishte përmendur një hadith të shpikur? Çfarë të garanton se të dy ju do të jeni të gjallë, kur Islami të ketë një shtet? Çfarë të garanton se do të kujtosh të gjitha lëshimet që nuk i ke ndrequr në vitet e kaluara apo të gjitha veprat e mira për të cilat nuk i ke urdhëruar të tjetër t'i bëjnë? Kur të shohësh dikë të bëjë një vepër të ligë, a do ta

²¹ Transmetuar nga Muslim (49).

vonosh qortimin e tij, derisa të vendoset shteti islamik, apo do të zbatosh hadithin e mësipërm:

"Kushdo prej jush që sheh një të keqe ..."

"E keqja" në hadith përmendet si emër i papërcaktuar, gjë që tregon se hadithi po i referohet të keqes së madhe dhe të vogël.

Metoda e Sahabëve në bërjen e dawetit mishërohet në rrëfimin e vdekjes së Umer ibn el-Khatib (radi Allahu anhu). Në vijim kemi një pjesë të tregimit që njofton për një ndodhi teksa ai (Umeri) po vdiste:

"... Pastaj ai (Umeri) u bart në shtëpinë e tij dhe ne shkuam me të. Dukej sikur njerëzit nuk kishin qenë goditur me fatkeqësi më të madhe para asaj dite. Një person tha: 'Në rregull është (dmth se ai do të shërohej)', ndërsa një tjetër tha: 'Kam frikë për të'. Atij (Umerit) iu soll *Nabiz* (ujë nga hurmat) dhe ai e piu atë, por më pas i doli nga trupi (nga vendi i plagës). Pastaj iu soll qumësht dhe ai e piu, por edhe kjo i doli nga vendi i plagës. Kështu, ata e morën vesh se ai po vdiste. Ne hymë tek ai dhe, po ashtu, hynë njerëzit tjerë. Ata nisën ta lëvdonin. Një i ri hyri dhe tha: 'Gëzohu, o Udhëheqës i Besimtarëve, me përgëzimet e Allahu për ty, se ishit shoqërues i të Dërguarit të Allahut dhe për atë se i shërbyet Islamit që nga ditët e hershme. Pastaj ti udhëhoqe dhe ishe i drejtë. Tash, (arrite) shehidllëk'. Umeri tha: 'Do të doja që kjo të vinte baras (dmth as kundër meje, as në favor timin)'. Kur i riu u kthye për të dalë, tesha e tij e poshtme po prekte tokën. Umeri tha: 'Ma thirrni djaloshin'. Ai tha: 'O biri i vëllait tim, ngrite teshën, sepse kjo do të bëjë që të të qëndrojë

tesha më shumë dhe do të jetë shenjë se i tutesh Allahut më shumë".²²

Umeri (radi Allahu anhu) e urdhëroi të riun të ngrinte teshat dhe të shkurtonte gjatësinë e teshës së poshtme. A ishte Umeri duke ngrënë fruta dhe ëmbëlsira, kur e këshilloi të riun? Jo, ai e këshilloi dhe e thirri të zbatonte një mësim të caktuar të Islamit ndërsa ishte në situatën më të rrezikshme. Ai e këshilloi të riun në kohën kur muslimanët po përjetonin një ankth, kur ai vetë po përballej me vdekjen dhe po përshëndetej me jetën. Muslimanët ishin të preokupuar me çështjen e kalifatit dhe ishin të shqetësuar me vdekjen e Umerit. Aq e madhe ishte frika e tyre, saqë kështu e përshkroi Amrun bin Mejmûn: "Dukej sikur njerëzit kurrë më herët s'kishin qenë goditur me fatkeqësi më të madhe". Umeri e këshilloi djaloshin të ngrinte teshën e tij (mbi nyje të këmbës) në një kohë kur trembëdhjetë burra nga Sahabët u goditën me thikë dhe shtatë prej tyre vdiqën.

Atëherë, si mund të thotë dikush: "S'është koha të ndalohen njerëzit nga lëshimi i teshave nën nyje të këmbëve. Tash s'është koha të paralajmërosh kundër bidateve. Tash s'është koha të inkurajosh njerëzit t'i përmbahen haditheve autentike dhe t'i lënë të dobëtat. Tash s'është koha të flasësh për çështje të këtitilla".

Nëse ndjehesh krenar të jesh nga populli i njëjtë si Umeri (radi Allahu anhu), atëherë ndiqe këtë rrugë. Mënyra e tij ishte të theksonte rëndësinë e ndjekjes së urdhrave të Allahut e të të Dërguarit të Tij. Ai (radi Allahu anhu) nuk e ndau fenë dhe të thoshte se gjëra të caktuara janë më të rëndësishme dhe duhet të zbatohen ndërsa të tjerat, ndonëse mund të jenë të obligueshme sa i përket zbatimit, paraqesin lëvozhgën e jashtme të Islamit, kështu që nuk janë aq të rëndësishme. Por, ai iu bind Allahut të

²² Transmetuar nga *el-Buhari* (3700). Komenti që vijon është nga libri im "Tregimi i vrasjes së Umer ibn el-Khatab".

madhërishëm në çdo çështje për të cilën dinte, pavarësisht se a ishte ajo dije nga Libri i Allahut fuqiplotë apo nga Sunet i të Dërguarit (salallahu alejhi ue selam).

Sa e sa mësimet i lëmë ngaqë mendojmë se ato janë çështje sekondare, të cilat na shmangin nga xhihadi dhe nga vendosja e sheriatit të Allahut në tokë?

Ku është ai xhihad të cilin e bëjmë dhe ku është ai shtet islamik që e realizuam?

Ne as nuk kemi bërë xhihad, as nuk kemi vendosur sheriatin në tokë; e as nuk u kemi shmangur bidateve dhe veprave të ndaluara.

Unë nuk shoh ndonjë konflikt mes synimeve tona të ndryshme. Le të përgatitemi për xhihad në rrugë të Allahut të lartësuar, le të mundohemi të vendosim ligjin e Allahut në vend, dhe, po ashtu, le të ndalojmë njëri-tjetrin nga bidatet dhe veprat e këqija, ndërsa thërrasim njëri-tjetrin të bëjmë punë të mira. Në çfarë mënyre përjashtojnë njëra-tjetrën këto detyra?

Mungesa e të kuptuarit

Kjo meqë çështjet e rëndësishme janë të paqarta në mendjet e një numri të madh muslimanësh që thonë: "Këto janë detaje të parëndësishme. Këto janë dallime me të cilat s'duam të merremi. Ka çështje më të rëndësishme". Si rezultat i mosnjohjes së vendimeve të Allahut në çështje të caktuara, shumë njerëz të tillë pa qëllim i zënë asgjë urdhrat e Allahut.

Në një rast, menjëherë pas namazit, një vëlla i mirë dhe një thirrës i një organizate islamike më tha: "*TekabelAllah* (Allahu pranofte nga ne), por ndoshta ju do të thoni se kjo është bidat (dmth të thuash *TekabelAllah* pas namazit është bidat)".²³

Pasi diskutova çështjen me të, në fund i thash: "Më jep vetëm një shembull të një bidati në fe. Zgjidh cilindo shembull që do ti". Pasha Allahun, ai s'ishte në gjendje të sillte ndonjë shembull, pavarësisht faktit se kishte kryer një nivel të lartë të edukimit (Islamik) dhe ishte i përfshirë në thirrjen e të tjerëve për në rrugë të Allahut të lartësuar. Përse ishte kështu puna e tij? Sepse ai s'kishte kuptuar qartë metodologjinë e dijetarëve (në mësim). Dhe ka shumë persona si ky vëllai.

Problemi i tyre qëndron në atë se në argumentimin se një bidat është bidat, ata mbështeten në tekstet e përgjithshme të shpallura. Për shembull, ata mund të thonë se është e lejueshme që muezini të çojë salavate mbi peygamberin (salallahu alejhi ue selam) pasi ta kryejë ezanin, duke e bërë kështu atë pjesë të

²³ Nëpërmjet induksionit nga parimet ligjvënëse, e dimë që kjo frazë është e lejueshme, nëse nuk përdoret vazhdimisht (sit ë ishte pjesë e namazit). Ky vendim është shprehur qartë nga disa dijetarë. Mirëpo, që ta thuash vazhdimisht (sikur të ishte pjesë e namazit apo Sunet) kërkon dëshmi, sepse vendimi në çështjet e adhurimit është se ajo vepër është e ndaluar po që se s'ka dëshmi për të.

ezanit. Teksti i përgjithshëm në të cilin ata mbështeten në të këtë çështje është thënia e Allahu të madhëruar:

إِنَّ اللَّهَ وَمَلَائِكَتَهُ يُصَلُّونَ عَلَى النَّبِيِّ يَا أَيُّهَا الَّذِينَ آمَنُوا صَلُّوا
عَلَيْهِ وَسَلِّمُوا تَسْلِيمًا

"Allahu çon *salātet* (mëshirën, nderin, bereqetin, etj.) mbi pejgamberin dhe, po ashtu, Engjëjt e Tij (duke kërkuar falje e bereqet për të)". (el-Ahzab, 56)

Në një tjetër shembull, ata mund të thonë se, bazuar në ajetin vijues, është e lejueshme që njerëzit të bëjnë *dhikr* njëzëri, zëshëm dhe vazhdimisht.

فَاذْكُرُونِي أَذْكُرْكُمْ

"Më kujtoni Mua, Unë ju kujtoj juve". (el-Bekare, 152)²⁴

Sa i përket çështjes së njëjtë, ata mund të citojnë këtë thënie të pejgamberit (salallahu alejhi ue selam):

"Ju duhet të mbaheni me Xhematin, se ujku e han delen e vetmuar".²⁵

²⁴ Ata gjithashtu citojnë hadithin e shënuar në Muslim (384):

"Kur të dëgjoni muezinin, thoni çfarë thotë ai, pastaj çoni *salavate* mbi mua ..."

Kjo në asnjë mënyrë nuk mbështet këtë qëndrim. Së pari, ky hadith u adresohet jo muezinint, por atyre që e dëgjojnë atë. Së dyti, pejgamberi (salallahu alejhi ue salm) tha: "... pastaj thuaj çfarë thotë ai, pastaj dërgo *salavate* mbi mua ...". Sikur muezinin të kishte çuar *salavate* mbi pejgamberin (zëshëm, pas ezanit), pejgamberi s'do të kishte thënë: "Pastaj çdo *salavate* mbi mua", sepse thënia e tij "Thuaj çfarë thotë ai" do ta kishte mjaftuar.

Sigurisht që është e ndaluar të refuzohen këto ajete e hadithe. Por, ajo çka ne refuzojmë me të drejtë, është mënyra se si njerëzit nxjerrin vendime të gabuara prej tyre si në çështjet e përmendura më lart, ashtu dhe në çështje tjera.

Le të supozojmë se një njeri fal pesë rekate në namazin e jacisë më vend të katër rekateve të ligjësuara. A do të thoshte një person që përgjithësisht pranon bidatet se ky verim është i ligjësuar apo dhe i lejuar? Nëse thotë "jo" - dhe ai s'ka zgjedhje tjetër veçse të thotë "jo" -, atëherë do t'i themi atij: "Mirë. Namazi ka një pozitë të lartë e të rëndësishme në fe, dhe ky është një fakt i vërtetuar në shumë ajete të Kuranit dhe thënie të pejgamberit (salallahu alejhi ue selam). Sa herë që një person bën sexhde Allahut të madhërishëm, ai i afrohet Atij më shumë, meqë Allahu i patëmeta thotë:

وَأَسْجُدْ وَاقْتَرِبْ ﴿١٨﴾

"... bjer në sexhde dhe afroju Allahut" (el-Alak, 96)

Dhe pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) thotë:

"Robi më së afërti Allahut është kur bën sexhde, kështu që luteni Atë shumë dhe shpesh (kur të jeni në sexhde)".²⁶

Ky ajet i qe bërë i njohur të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selam) para çdo qenie njerëzore tjetër, sepse atij i qe shpallur dhe kjo është e vërteta nga Zoti yt. Megjithëkëtë, i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) nuk e urdhëroi as Bilalin (radi Allahu anhu) e as ndonjë tjetër muezin që të çonte *salavate*

²⁵ Ky hadith është *hasen* dhe shënohet nga Ahmed, Ebu Daud, en-Nesa'i, Ibn Khuzejmeh, Ibn Hibban (këta dy të fundit e shënojnë në përmbledhjen *Sahi* të tyre) dhe el-Hakim. Referoju *Nusus Hadithijeh* (f.13) dhe *Sahih et-Terghib uel-Terhib* (f.427).

²⁶ Transmetuar nga Muslim (482).

mbi të zëshëm dhe menjëherë pas ezanit. Dhe, me sa e di unë, kjo praktikë s'ka të bëjë me Sahabët (radi Allahu anhum), pavarësisht faktit se ezani që bërë në raste të shumta, kështu që, sikur dikush të praktikonte këtë gjatë kohës së pejgamberit (salallahu alejhi ue selam), ky lajm do të na mbërrinte.

Tash, mund të kuptosh përse thirrësi (*da'i*) i cili u fal pranë meje nuk ishte në gjendje të jepte qoftë dhe një shembull. Ai, njëjtë si ata si puna e tij, mbështetet në tekstet që japin vendime të përgjithshme. Edhe sikur ai të përmendte një bidat, unë do të mundja – po të vazhdoja me metodologjinë e tij të gabuar – të përmendja një argument të përgjithshëm për të ligjësuar bidatin, mu siç bën ai për të ligjësuar bidatet tjera. Kjo është arsyeja përse kemi nevojë për një bazë të fortë për të kuptuarit tonë të bidatit.

Nëse pajtohemi se bidatet ekzistojnë, atëherë duhet të pyesim si të dallojmë bidatin nga Suneti. Sipas pikëpamjes sime, kësaj pyetje në mund t'i përgjigjemi duke kërkuar gjithmonë tekstin e shpallur, i cili në veçanti vërteton apo lejon një akt të adhurimit. Pra, nëse një person dëshiron të thërrasë ezanin për namazin e xhenazes apo për namazin e bajramit ndërsa përmend vlerat e ezanit për të avancuar pohimin e tij, ne do t'i themi: "A ka diçka të transmetuar nga pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) apo nga Sahabët e tij lidhur me thirrjen e ezanit për namazin e xhenazes apo atë të bajramit?"

Ngjashëm, nëse dikush dëshiron të falë namazet sunet (*er-Rewâtib*) me xhemat bazuar në hadithin: "**Ju duhet të mbaheni me xhematin**", ne do të themi: "Por, a është transmetuar ky veprim i veçantë nga pejgamberi apo nga Sahabët e tij?"

Nëse nuk e zbatojmë këtë metodologji në dallimin mes Sunetit dhe bidatit, çdo akt adhurimi do të ligjësohet pa pasur nevojë për dëshmi dhe bidati s'do të ekzistonte.

Në një transmetim nga Ebi es-Selt, një burrë i shkroi Umer ibn AbdulAzizit që ta pyeste për paracaktimin hyjnor (kaderin). Umeri i shkroi përgjigje:

"Në vijim, të këshilloj t'i tutesh Allahut, të mos e teprosh (në kuptimin e shtimit në fe) apo të jesh i shkujdesur ndaj urdhrit të Tij, të pasosh Sunetin e peygamberit të Tij, dhe ta lësh atë që shpikën bidatçinjtë. Suneti i peygamberit (salallahu alejhi ue selam) është vërtetuar dhe kjo të mjafton që të mos mbartësh ndonjë bidat. E ke për detyrë që t'i përmbahesh Sunetit, se vërtet që kjo, me lejen e Allahut, do të jetë mbrojtje për ty. Ta dish se njerëzit nuk kanë paraqitur ndonjë bidat veçse një mësim apo argument ka ardhur para tij për të vërtetuar se ajo përnjëmend është një bidat. Vërtet, ai që ka zbatuar Sunetin, e ka ditur atë që është e kundërt me të sa i përket gabimeve, budallallëkut dhe teprimit. Pra, ji i kënaqur me atë që ishin të kënaqur njerëzit (dmth paraardhësit e devotshëm)".²⁷

Përmbledhtazi, për çdo akt të veçantë adhurimi kemi nevojë për dëshmi të veçantë, sepse bidatet vlerësohen të jenë të ligjshme bazuar në tekstin e shpallur me karakter të përgjithshëm në zbatim. Thënia e Umer bin AbdulAziz e konfirmon këtë rregull. Dhe suksesi qëndron me Allahun e madhërishëm.

²⁷ Transmetuar nga Ebu Daud (*Sahih Sunen ebi Daud* 3856).

Ta njohësh Allahun e madhëruar

Nëse një person beson se Allahu dëgjon gjithçka, sheh gjithçka dhe di gjithçka, dhe se s'ka gjë si Ai, atëherë ai është më i kualifikuar se të tjerët të dijë se gjykimi i Atij që dëgjon gjithçka, s'është sikurse gjykimin i atyre dëgjimi i të cilëve është më i dobët se i Tij; se gjykimi i Atij që sheh gjithçka, s'është sikurse gjykimi i atyre shikimi i të cilëve është më i dobët se i Tij; se vendimi i të Gjithëdijshmit s'është sikurse vendimi i atyre që kanë dije më pak se Ai; dhe atë se s'ka gjë si Ai sa i përket Qenies së Tij, Emrave dhe Cilësive të Tij, s'ka gjykim dhe vendim si gjykimi dhe vendimi i Tij, dhe s'ka ligj si ligji i Tij.

Mirëpo, është gabim të ndash një kategori të teuhidit nga tjetra, apo të largosh e të shkëputësh disa tekste nga tekstet tjera të shpallura.

Ibn Umer (radi Allahu anhu) transmetoi se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) tha:

"Vërtet, popujt para jush nuk kanë qenë shkatërruar, derisa ata bënë të ngjashmen me këtë, duke përdorur pjesë të Kuranit kundër pjesëve tjera të Kuranit. Sa i përket asaj që është hallall, konsiderojeni hallall; sa i përket asaj që është haram, konsiderojeni haram. Kurse, sa i përket *muteshabih* (ajo që është e paqartë për njerëzit apo e kuptojnë vetëm dijetarët), besoni në to".²⁸

²⁸ Hadith i vërtetë i transmetuar nga et-Taberāni në *el-Kebir* dhe tjerët, po ashtu, e transmetuan. Kjo është nga *Sahih el-Xhami* (1334). Referoju *es-Sahih*a (1522).

Efektet e këqija të gjynaheve

Ibn Umer transmetoi se i Dërguari i Allahut (salallahu alejhi ue selam) tha:

"O ju muhaxhirë, kur të sprovoheni me pesë çështje ... dhe kërkoj shpëtim te Allahu që ju te jeni të pranishëm, kur ato të ndodhin:

1. Nuk shfaqet midis njerëzve ndonjë ligësi (si kurvëria) dhe ta bëjnë atë haptazi veçse tek ata do të përhapen sëmundjet dhe vuajtjet që nuk kanë ekzistuar më parë midis paraardhësve të tyre.
2. Ata nuk do të lënë mangët në matje dhe peshojë (dmth e mashtrojnë njëri-tjetrin në tregti) veçse do të goditen me thatësi, me kushte të vështira dhe me tirani nga pushtetari.
3. Ata nuk do ta thyejnë besëlidhjen me Allahun dhe me të Dërguarin e Tij veçse Allahu do t'i japë mundësi mbi ta një armiku që s'është prej tyre, që do t'ua marrë një pjesë të asaj që kanë në duart e tyre.
4. Për sa kohë që udhëheqësit e tyre të mos gjykojnë me Librin e Allahut dhe zgjedhin nga ajo që Allahu shpalli (duke marrë veç atë që u pëlqen), Allahu do të bëjë që ata të vuajnë nga njëri-tjetri (dmth do të luftojnë mes vete)"²⁹.

Në këtë hadith, pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha:

²⁹ Transmetuar nga Ibn Maxheh, Ebu Nu'ejm në *el-Hiljeh*, dhe të tjerët. Ky është hadith *sahih*, dhe shejhu jonë (Albani) – Allahu e pastë mëshiruar – e shënoi në *es-Sahih*a (106).

"Ata nuk të lënë mangët në matje dhe peshojë (dmth e mashtrojnë njëri-tjetrin në tregti) veçse do të goditen me thatësi, me kushte të vështira dhe me tirani nga pushtetari".

Kjo dëshmon se gjynahet rezultojnë në tirani nga ana e pushtetarit si dhe në gjykimin me tjetër veç asaj që Allahu i madhëruar shpalli.

Rëndësia e dijes

Si do të vendosim sheriatin e Allahut në tokë pa dije?

Me anë të cilit medhheb do ta arrijmë këtë?

Për të vendosur Sheriatin e Allahut në tokë, ne na duhen dijetarë e nxënës dijeje, na duhet hulumtim shkencor, duhet të jemi të zellshëm dhe të duruar, dhe duhet të punojmë shumë dhe të ngremë nivelin tonë të besimit nëpërmjet edukimit dhe trajnimit.

Çdo vëllait fisnik që mundohet të arrijë mirësinë dhe ta luftojë të keqen e devijimin i them: Allahu të bekoftë në përpjekjet tua, por mos harro të mbartësh shpatën e dijes. Si mposhten besimet e rreme? Pasha Allahun, ju s'do të mund t'i jepni fund besimeve të rreme pa dije. Sa e sa njerëz kanë debatuar me ithtarët e besimeve të rreme vetëm që të mposhteshin për shkak të dijes së pakët! Të supozojmë që ti mundohesh ta bindësh dikë se ka besim ta gabuar; a ke dije që më pas t'ia mësosh besimin dhe metodologjinë e saktë?

Në të mësuarit e të tjerëve, personi natyrisht s'mund të mbështetet në gjë më të mirë sesa në Kuran e Sunet si dhe në udhëzimin e paraardhëse tanë të devotshëm. Që të mësosh njerëzit bazuar në këto burime, duhen dijetarë, nxënës dijeje, libra të besueshëm dhe aftësi për të dalluar mes të saktës e të pasaktës.

Shembuj të mendjemadhësisë dhe përçmimit

Në vijim kemi shembuj të njerëzve apo llojeve të tyre të cilët nuk e kuptojnë se çka do të thotë të gjykosh me atë që Allahu i madhëruar shpalli.

- Një person thotë (ndoshta në ndonjë darkë): "Ne duam që sheriatit të Allahut të zbatohet si sistem dhe mënyrë jete", por ai nuk i di gjykimet, urdhrat dhe ndalimet e Allahut në çështjet më themelore lidhur me namazin, agjërimin, veshjen, gostitë martesore apo funeralet.
- Një tjetër person përqesh dijetarët dhe librat fetarë duke thënë: "Këta po na largojnë nga xhihadi dhe nga vendosja e sheriatit të Allahut në tokë!"
- Kur të dëgjojë dikë të thërrasë njerëzit për mirësjellje, dikush thotë: "Këto janë vogëlsira". Po kështu shprehet edhe kur të dëgjojë se dikush paralajmëron kundër bidatit, haditheve të shpikura dhe imitimit të mosbesimtarëve, dhe thotë të njëjtën gjë kur të dëgjojë dikë të flasë rreth vlerës së përmendjes (*dhikrit*) të Allahut të lartësuar.
- Dhe, kur ndonjëri të dëgjojë vendime të caktuara të sheriatit, ai thotë: "Këto çështje na e heqin vëmendjen nga luftimi kundër të devijuarve, ideve materialiste dhe grupeve të humbura", ndonëse, nëse kërkon prej tij të përgënjeshtrojë idetë për të cilat flet, ai s'do të jetë në gjendje të japë një përgjigje të kuptueshme.
- Një tjetër thotë: "Këta dijetarë janë dritëshkurtër dhe tepër të kufizuar në pikëpamjet e tyre. Pikëpamja ime, në anën tjetër, është gjithëpërfshirëse dhe e plotë". Kështu, ai

i nënçmon dijetarët. Por, cili është realiteti i qasjes së tij gjithëpërfshirëse? Me çfarë dije nga fikhu ai mund të krenohet? Ai vazhdimisht flet për politikë, por çka di ai rreth kësaj teme? Çka di ai rreth ekonomisë? Dhe çka di ai rreth moralit islamik? Ndonëse ai flet për gjithëpërfshirje, dija e tij është gjithçka përveç gjithëpërfshirëse. Në fakt, s'do të ishte larg cakut sikur të thoshim se ai s'mbart gjë tjetër përveç fjalës "gjithëpërfshirje".

- Një tjetër thotë: "Ne s'mund të bëjmë gjë, derisa të kemi një kalif të udhëzuar drejt". Nëse zhvillohet ndonjë bisedë që nuk përmend këtë temë, ai do të çirret për dritëshkurtësinë e atyre që vazhdojnë bisedën.
- Një tjetër thotë: "Shtegu ynë është ai i dijes dhe i pasimit (të Sunetit), pa pasuar verbazi (ndonjë person apo një grup)", por do të gjeshe se ai vetë pason verbazi, nuk ka dije dhe krejt çka posedon është një slogan. Megjithatë, ai pa pasur dije i akuzon të tjerët për injorancë dhe devijim.
- Një tjetër sillet sikur gjykimi lidhur me mjekrën dhe veshjen dhe gjërat të ngjashme s'ka të bëjë gjë me veprën; mjafton të kesh një të mirë në këso çështjesh. Sipas tij, gjykimi me atë që Allahu shpalli ka të bëjë me gjëra tjera.
- Një tjetër thotë për shumë çështje të sheriatit: "Këto janë lëvorja", por do të gjeshe se ai bile nuk i zbaton ato që i konsideron thelb të Islamit. Ai polemizon vetëm e vetëm që t'i ikën zbatimit të mësimave të caktuara islamike.

Këshilla ime për një person që i kritikon ata të cilët mundohen të zbatojnë fenë është që të pyesin vetveten: Çka kam kontribuar për veten time, për familjen dhe për muslimanët? Çka kam

realizuar nga punët e mira? Dhe çka kam bërë nga punët e këqija?

Abdullah ibn Mes'ud (radi Allahu anhu) transmetoi se pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) kishte thënë:

"S'do të hyjë në Xhenet ai që ka në zemrën e tij mendjemadhësi sa një thermi (apo sa pesha e një milingone)". Një burrë reagoi: "Vërtet që burri ka dëshirë ta ketë veshjen dhe mbathjet e mira". Pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha: "Vërtet, Allahu është i bukur dhe e do bukurinë. Mendjemadhësi është të refuzosh të vërtetën dhe të përçmosh njerëzit"³⁰.

Dhe pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha:

"Tri janë që shkatërrojnë dhe tri janë që shpëtojnë. Tri që shkatërrojnë janë koprracia të cilës i bindemi, dëshira që pasohet, dhe pasja e mendimit të lartë për vetveten.

Tri që shpëtojnë janë: frika ndaj Allahut si në privatësi, ashtu dhe në publik; matura si në skamje, ashtu dhe në kamje; dhe drejtësia në hidhërim dhe në kënaqje"³¹.

Shih sesi pasja e mendimit të lartë për vetveten është shkak i shkatërrimit, sesi drejtësia në hidhërim dhe në kënaqje të shpëton (nga shkatërrimi). Kështu, e lusim Allahu e madhëruar të na bekojë me drejtësi në të gjitha çështjet tona në gjykimin ndaj grupeve dhe thirrjeve të tyre, pavarësisht se a jemi të hidhëruar apo të kënaqur. Vërtet, Ai, më i larti, ka pushtet mbi gjithçka.

³⁰ Muslim (91).

³¹ Nëse i marrim në konsideratë të gjithë zinxhirët e këtij transmetimi, ky hadith është *hasan*. Për hollësira rreth këtij hadithe referoju *es-Sahih* (1802).

Në fund, dua ta rikujtojë vetveten dhe vëllezërit e mi lidhur me hadithet e rëndësishme në vijim.

Musab ibn Sa'ad na e përcolli nga babai i tij se atij iu dukë se kishte merita (ndoshta për shkak të forcës e trimërisë së tij) ndaj atyre që ishin nën të nga Sahabët e të Dërguarit të Allahut (salallahu alejhi ue selam), kështu që i Dërguari tha:

"Vërtet, Allahu e ndihmon këtë umet vetëm nëpërmjet të dobëtëve të tij, nëpërmjet lutjes që ata bëjnë, namazit të tyre dhe singëritetit të tyre"³².

Në hadith tjetër, pejgamberi (salallahu alejhi ue selam) tha:

"Kërkoni me zell të dobëtit për mua (apo "m'i afroni të dobëtit", apo "përmbushni të drejtat e të dobëtëve, pyetni se si i kanë punët dhe jini bujar ndaj tyre), sepse ju furnizoheni dhe ndihmoheni vetëm për shkak të tyre (apo "vetëm nëpërmjet tyre ju furnizoheni dhe ndihmoheni)"³³.

³² Transmetuar nga en-Nesa'i dhe të tjerët. Po ashtu, gjendet në *Sahih el-Buhari* dhe në kompilime tjera, por pa e përmend singëritetin. El-Mundhirij përmendi këtë në *et-Terhib uel-Terhib* (1/54). Ky është një hadith i vërtetë, dhe diskutohet hollësisht në *es-Sahih* (2/423).

³³ Transmetuar nga Ebu Daud, en-Nisa'i, et-Tirmidhi, dhe të tjerët. Ky është një hadith i vërtetë, dhe diskutohet gjatë në *es-Sahih* (779).

Përfundim

Këtu merr fund ajo që munda të shkruaja lidhur me këtë temë, dhe krejt lavdërimi i takon Allahut për ndihmën dhe udhëzimin e Tij. E lus Atë që të më frymëzojë të zbatoj atë për çka shkrova dhe ta pranojë këtë punë nga unë. Dhe e lus Atë që t'u bëjë dobi burrave dhe grave muslimanë në të gjitha anët e botës nëpërmjet këtij libri. Vërtet, Ai dëgjon gjithçka, di gjithçka.